



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Mbështetje për Parlamentin
dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri

FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE NË ZONAT RURALE

PËRGATITUR NGA **ETLEVA DASHI**, PEDAGOGE UBT

MAJ 2022

HYRJJE

Barazia gjinore përfshin tërësinë e të gjitha politikave ekonomiko-sociale, si një nga objektivat më të rëndësishëm të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030. Në këtë kuadër çështjet e barazisë gjinore vazhdojnë të jenë shumë të diskutuara. Megjithëse qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash të rëndësishme, pabarazia gjinore vazhdon të mbetet një nga problemet kryesore me të cilat përballet shoqëria shqiptare.

Hendeku shoqëror që ekziston në Shqipëri mes grave dhe burrave është më evident e më i theksuar në zonat rurale. Nisur nga ky këndvështrim, cilat janë shkaqet që ndikojnë në thellimin e këtij hendeku dhe çfarë masash mund të gjenden për të zbutur këto efekte?

Është tashmë i njohur roli i gruas në zhvillimin ekonomik të zonave rurale. Sipërmarrja dhe përpunimi i produkteve nga ana e tyre mbeten një fenomen që jo vetëm rrit nivelin e të ardhurave në familje por edhe të rolit të saj ekonomik. Gruaja është anëtare e barabartë e familjes bujqësore dhe gëzon të drejtën e bashkëpronësisë me pjesëtarët e tjerë, por atë e gjejmë rrallëherë si kryetare të kësaj familje.

PROBLEMATIKA

Legjislacioni dhe politikat që mbështesin rregullimin e barazisë gjinore në Shqipëri dhe sidomos në zonat rurale mbeten akoma një sfidë përse i përket implementimit të tyre. Në kuadër të procesit të përafrimit me acquis të Bashkimit Europian si dhe rekomandimeve të Komitetit CEDAW (2016) dhe GREVIO (2017), janë miratuar disa akte të rëndësishme ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje, diskriminimin në punë, punën e papaguar, aktivitetin formësor të gruas, në familje, shkollim, shoqëri dhe punë. Vlen të theksohet se puna e qeverisë ka mundësuar krijimin e Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore që prej vitit 2016 e në vijim, dhe aktualisht është në zbatim Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore 2021-2030 e lidhur dhe me Strategjinë Barazisë Gjinore 2020-2025 të Bashkimit Evropian.

Në vitin 2021 pesha totale e grave në popullsi ishte 50.2%, me një jetëgjatësi prej 4.4 vite më shumë se burrat dhe koeficienti i varësisë së të moshuarve është 1.7% më shumë për gratë. Në këto tregues vërehet qartë se gratë kanë një diferencë të shprehur edhe në vlerë gjatë jetës aktive gjë e cila ndryshon gjatë periudhës së mbështetjes sociale apo varësisë së të moshuarve pasi pesha e përfitimeve për gratë është më e madhe krahasuar nga ajo e burrave qoftë në vlerë por edhe në kohë pasi gratë kanë një jetëgjatësi më të lartë.

Ndërkohë që gjatë jetës aktive (15-64 vjeç) punëzënia për gratë është 61.2%, ndërsa për burrat është 77.1 % (INSTAT 2021). Kjo diferencë në punëzënie i atribuohet gjinisë e cila vijon të ketë preferencë për punëzënie edhe pse jo në forma të hapura diskriminuese. Por diferenca në tregun e punës nuk është vetëm në nivelin e punëzënies por edhe në vlerën e pagës pasi në rang kombëtar paga mesatare për gratë është 6.6% më e ulët se ajo e burrave (INSTAT 2021). Duhet përmendur se hendeku gjinor i pagave është ulur

pasi në vitet paraardhëse ka qenë 10.1% sipas INSTAT. Në kushtet që Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 136/2015 ka pasur si qëllim zbutjen dhe zhdukjen përfundimisht të kësaj pabarazie vërehet se duhen shtuar drejtimet në të cilat mund të ndikohet akoma ulja e pabarazisë.

Megjithëse kuadri ligjor dhe përpjekjet e qeverisë shqiptare i kanë krijuar kushtet paraprake të nevojshme, përfshirja e gruas në shumë fusha të shoqërisë tonë mbetet një shqetësim. Sidomos gratë në zonat rurale vijojnë të kenë kufizime të theksuara në përfitimet që i siguron ky format ligjor. Kuadri ligjor dhe implementimi dhe sidomos lidhja ndërmjet barazisë gjinore dhe strategjisë për zhvillimin rural kanë nevojë për përmirësime të prekshme. Kjo situatë është pasojë e implementimit të ngadaltë dhe të paplotë edhe nga shoqëria jonë. Gratë në zonat rurale janë të kufizuara me aktivitetet vetëm brenda fermës, rrethanë kjo që nuk mund të thyhet pa dëshirën apo emancipimin e shoqërisë tonë. Fuqizimi i gruas duhet të ngrihet në gjithë aktivitetet që lidhen me fermën por edhe jashtë saj në zonat rurale.

Në procesin e shërbimit të ekstensionit apo organizimeve të tjera përfituesi fundor i tyre ka qenë kryesisht kryefamiljari që në shoqërinë shqiptare kryesisht është burri. Ligji dhe politikat e ndjekura deri tani nuk e kanë lehtësuar situatën që gruaja fermere të jetë në kushte të barabarta për fuqizimin e saj pasi fillimisht dhe në mënyrë të vazhdueshme duhet të mundësohet akses në informacion dhe kapacitet e saj për kontribut organizativ ose teknik, fillimisht në fermën familjare por edhe më tej.

A. AKSESI I ULËT I GRAVE RURALE NË BURIMET FINANCIARE DHE KREDITIM

Gratë në zonat rurale janë të margjinalizuara pasi kanë mundësi të ulëta përfaqësimi dhe deri në pamundësi aksesimi të të gjitha kërkesave që ka gjendja ekonomike e familjes ku ajo bën pjesë. Këtë përfundim e gjejmë edhe në shifrat zyrtare që ofron INSTAT dhe Ministria e Bujqësisë. Në vitin 2020, ndërmarrjet aktive në sektorin e bujqësisë që zotërohen ose administrohen nga gratë përbëjnë vetëm 11.4%. Megjithëse kemi një numër jo të ulët të kredimarrëseve gra në tregun financiar (43.2% sipas INSTAT 2021), kjo vlerë i referohet të gjithë Shqipërisë pasi në total kreditimi për sektorin e bujqësisë ka përthithur vetëm 1.6% të totalit të kreditimit të ekonomisë (Banka e Shqipërisë 2020). Po ashtu akses në tërësi i popullsisë rurale në sistemin bankar është i ulët. Kufizimi i aksesit të burimeve financiare bankare në zonat rurale vjen edhe si pasojë e menaxhimit të riskut që operatorët financiarë ndjekin. Bankat e mëdha, bazuar në raportet e tyre, kanë vlerësuar një risk të lartë të moskthimit të kredive. Gjithashtu edhe shoqëritë e mikrofinancës, të cilat marrin një risk më të lartë kreditimi, kanë në zonat rurale rreth 27% të totalit të klientëve të tyre. Ndërkohë që vetëm për gratë në zonat rurale, kreditimi nga këto shoqëri varion rreth 24% të sektorit agro të financuar prej tyre në total.

Në nivel të ulët vlerësohet edhe akses i grave rurale në fondet e skemave kombëtare që menaxhohen nga AZHBR. Sipas publikimit për vitin 2021, rezultojnë rreth 11% gra që kanë përfituar nga kjo skemë.

Aksesi në burimet financiare nuk varet vetëm nga distanca e shërbimeve financiare në zonat rurale por edhe nga struktura përthithëse e fermës dhe familjes bujqësore. Në këtë pikë duhet vlerësuar ndikimi që duhet të kenë politikat lehtësuese nga lart-poshtë, pasi kushte janë ato që i paraprijnë suksesit. Pra rritja e kapaciteteve të grave rurale do të rriste kushtet për të përthithur më shumë burime financiare si nga tregu ashtu dhe nga skemat mbështetëse. Vlen të theksohet se ky nivel i grave rurale që ka akses në burimet financiare të cilësuar më sipër kanë ardhur si rrjedhojë e një pune të madhe nga të gjitha drejtimet por sidomos nga modelet e përparuara të donatorëve dhe investitorëve të huaj.

Suksesi i një gruaje si drejtuese ferme është i vështirë pasi modeli i fermave shqiptare vijon të ketë teknologji të prapambetur. Parcelizimi i tokës bujqësore në vendin tonë krijon një nga barrierat kryesore të modernizimit të fermave. Bashkëpunimi i fermerëve për të përballuar kostot e larta të teknologjisë moderne dhe standardin e produktit të kërkuar nga tregjet ndërkombëtare është e vetmja rrugëzgjdhje. Ky bashkëpunim ka ecur me ritme të ulëta pasi ndërgjegjësimi i fermerëve dhe kushtet e fermave të tyre vijnë jenë të lidhura me pengesa të modelit që ata operojnë. Padyshim që edhe emancipimi i grave fermere për të drejtuar ferma apo të aksesojnë shërbimet e ekstensionit të ofruara nga strukturat shtetërore nuk pritet që të jetë i menjëhershëm.

Përmirësim në drejtim të kushteve të barazisë gjinore ka pasur në kuadrin ligjor të pronësisë në zonat rurale i cili është thuar se i plotë pasi i referohet Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 dhe i ndryshuar në vite, në seksionin e bashkëpronësisë për familjet bujqësore dhe Kodin e Familjes për bashkëpronësinë e bashkëshorteve. Aktet rregullatore janë përmirësuar edhe ligjin për noterinë nr. 110/2018, ku i detyron noterët që në aktet për kalimet e pronësisë të provojnë me dokumentacion sipas regjistrave të gjendjes civile në referim të Kodit të Familjes nëse palët janë të martuar dhe nëse preken nga këto veprime. Gjithashtu ligjet i fundit për legalizimet e tokave bujqësore në vitin 2018 dhe 2020 ka rritur pritshmëritë që një pjesë e madhe e këtyre tokave të regjistrohet me certifikatë pronësie duke u krijuar kushtet për akses me të gjerë në tregjet e kapitalit financiar për të gjithë fermerët.

B. INFORMALITETI DHE PUNA E PAPAGUAR

Në vitin 2020, 36.1% e popullsisë Shqiptare është e punësuar në bujqësi, ndërkohë që niveli i grave të punësuar në këtë sektor është 41.4% (INSTAT 2021). Shkalla e papunësisë për gratë në Shqipëri është 12.4% ose 0.4% më e lartë se burrat. Niveli i migrimin të brendshëm për vitin 2020 është 34.009 banorë dhe 61% e tyre ishin gra. Ndërkohë 18.8% e grave nuk janë të zëna me punë për shkak të angazhimit në familje me rritjen e fëmijëve.

Gratë rurale konsumojnë dukshëm më shumë kohë në përgatitjen e ushqimit, pastrimin, kujdesin ndaj fëmijëve dhe të tjera aktivitetet shtëpiake sesa gratë në zonat urbane. Kjo situatë redukton mundësinë për edukim dhe punësim më të mirë të tyre. Të gjithë këta tregues referojnë kontributin ekonomik të gruas rurale, nivel të ulët të të ardhurave nga puna që kryejnë edhe pse angazhimi në një kohë më të gjatë se gratë në zonat urbane për punë të papaguar në familje. Norma e lartë e migrimin drejt zonave urbane e grave rurale është një tregues i qartë se punëzënia e tyre në zonat rurale është informale, e pasigurt dhe e papaguar. Megjithatë skema për shpërbimin e lejes së lindjes ekziston prej

shumë kohësh, aktualisht në zonat rurale gratë përfitojnë shumë pak pasi nuk rezultojnë kontribuuese në këtë skemë. Por një nga arsytet se përse gratë rurale nuk përfshihen si kontribuuese në këtë skemë është dhe vlera e ulët e përfitimit pasi të ardhurat në sektorin ku janë të punësuar është i orientuar nga praktika e pagesës së kontributeve në nivelin minimal të kërkuar nga ligji.

REKOMANDIME

Në linjën e evidentimit të problematikave të cilësuara më sipër po paraqesim disa rekomandime në funksion të përmirësimit të menaxhimit në nivel institucional të çështjeve të barazisë gjinore dhe buxhetimin gjinor në fondet e bujqësisë.


- Rritja cilësore dhe sasiore e shërbimit të ekstensionit nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë në shpërndarje të drejtë gjinore edhe për anëtarët e tjerë të fermës.
- Rritja sasiore e shërbimit të ekstensionit me shpërndarje të drejtë gjinore të parashikohet duke detyruar nëpërmjet regjistrave të popullsisë pjesëmarrjen e grave në frekuenca të njëjta me ato të burrave. Ky shërbim të orientohet jo vetëm për drejtuesit e fermave, të cilët kryesisht janë burrat si kryefamiljarë, por të delegohet prej tyre në anëtarët e tjerë të familjes.
- Nxitjen e grave si drejtuese fermash për të aplikuar në skemat mbështetëse duke i vlerësuar paraprakisht me më shumë pikë se aktualisht krahasimisht me fermat që drejtohen nga burrat (sot vlerësohen me 10 pikë më shumë fermat që drejtohen nga gratë). Si dhe vlerësimin me më shumë pikë të fermave që drejtohen nga burrat që gjatë aplikimit provojnë shërbimet e ekstensionit për vitin e fundit nga gratë anëtare të fermës.
- Përfshirje më e gjerë e fondeve të skemave kombëtare dhe atyre të IPARD duhet të kushtëzohet edhe me përfshirjen e të gjitha grave në moshë aktive si bashkëpërgjegjëse në vlerësimin e pikëzuar për përfitimin ose jo të tyre. Duhet të përfshihet në vlerësim nga AZHBR edhe kapaciteti teknik dhe menaxherial i anëtarëve gra të familjes fermere përfituese të skemave mbështetëse qoftë kombëtare edhe ato të IPARD. Shtimi i vlerës së financimit do të krijojë tendencë për gjithëpërfshirje të gjithë familjes fermere pa dallim gjinie dhe aksesim direkt i burimeve të financimit edhe në sajë të aftësisë së grave në fermë.
- Krijimin e një kalendari efektiv me organizime sociale të grave fermere si hap i parë i krijimit të shoqatave të tyre për bashkëpunim të mëtejshëm. Është shumë e rëndësishme që fermat shqiptare të rrisin efikasitetin duke përfituar nga burimet financiare të IPARD. Këto burime mund të përfitohen vetëm duke rritur madhësinë e fermës nëpërmjet bashkimit të fermave familjare më të vogla. Në këto kushte mundësitë për sukses dhe përfitime janë më të mëdha. Mbështetja sociale mund të materializohet me mbështetje

lehtësuese nga përmirësimi i Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore duke e kanalizuar këtë mbështetje të parashikuar në seksionin “Aneks 4. Logjika e Ndërhyrjes, Institucionet Përgjegjëse, Afatet Kohore”. Në këtë aneks parashikimet për takime me gratë dhe motivimin e tyre dhe nxitjen e tyre për përfitimet ligjore dhe të tjera nga skemat sociale, pronësia mbi tokën janë parashikuar pa referenca të matshme. Në referenca të matshme do të duhet të përdoren gratë fermere ose si punonjëse të punëve të papaguara në shtëpi me anë të dhënave të sakta nga njësitë administrative dhe strukturat e ekstensionit në terren. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të arrihet në mënyrë kapilare kontakti me gratë e parashikuara në këtë strategji për t’u nxitur dhe angazhuar në veprime konkrete për përfitimet që ofron legjislacioni dhe sistemi për to në përmirësimin e të hyrave në ekonominë e tyre. .



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo- qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Projekt i:



Zbatuar nga:



Shënim: Pikëpamjet dhe përfundimet që jepen në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe të NDI – Institutit Demokratik Amerikan. Autorësia e këtij botimi i përket vetëm IDM-së.